



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-26-3898-2-3-6/C1153
14 Nr. 499/26
Dt. 15.06.2026

KONTRATË SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi, Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **Grup i Operatorëve Ekonomik HOTEL KROJET SH.P.K.; Qazim M. Mustafa B.I., Rr. Shqiponjat e Malit, Prevalle, Prizren,, Kosovë me ARBK : 810135253**, si Operator Ekonomik, të cilën e përfaqëson **z. Herolind Retkoceri** në tekstin e mëtejshëm **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Rekreacion në Prevallë të AK, me numër identifikues:

Nr. I prokurimit	VU644	2	6	38	9	8	2	3	6
Nr. I brendshëm	VU644	2	6	0	2		2	3	6

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : Aktivitete rekreative sociale dhe rehabilituese në Prevallë për klientët rezident në Shtëpinë Komunitetit për Persona me Aftësi të kufizuar mendore e fizike në Vushtrri. Qëllimi i aktivitetit është socializimi i klientëve, zhvillimi i autonomisë së individëve dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe atë të komunitetit në përgjithësi përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me shoqërinë, si dhe të kontribuojë në përmirsimin e shëndetit, rritjes së cilësisë së jetës, dhe rehabilitimit fizik., sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues VU644-26-3898-2-3-6.

1.1 Porositësi, Shtëpia Rezidenciale për persona me aftësi të kufizuar në Komunën e Vushtrrisë, ka përcaktuar si nevojë : Transportin me autobus të klientëve rezident në Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar mendore e fizike në relacionin : Vushtrri - LumMadh - Prevallë dhe anasjelltas, ashtu sikurse është saktësuar në Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit, me nr. brendshëm të Prokurimit : VU644 – 26 – 3898 – 2-3-6 ndërsa, O.E. - Kryesi i Shërbimit, duke angazhuar kapacitetet e tija njerëzore dhe teknike, pajtohet se do të kryej shërbimin sikurse u theksua më lartë. Qëllimi i aktivitetit sikurse është specifikuar dhe në dokumentin tenderik është socializimi klientëve, zhvillimi i autonomisë së individëve dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe atë të komunitetit në përgjithësi përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me shoqërinë, si dhe të

kontribuojë në përmirësimin e shëndetit, rritjes së cilësisë së jetës, dhe rehabilitimit fizik.

1.2. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet është: 18 persona (12 rezident dhe 6 punëtorë për përkujdesje ndaj klientëve).

1.3. Transporti me autobus dhe akomodimi i personelit do të bëhet gjatë muajit Qershor 2026, ndërsa koha e nisjes dhe e kthimit do të përcaktohet në marrëveshje mes Menaxherit të Kontratës të A.K. dhe menaxherit të Kontratës të Kryesit të Shërbimit.

1.4. Vendi i qëndrimit është : "Hotel Krojet "sh.p.k. me seli në Prevallë, me ARBK : 810135253 (sipas referencës së dhënë në Kontratën e bashkëpunimit, e dt. 15.06.2026, e lidhur mes Kryesit të Shërbimit dhe O.E. " Hotel Krojet "sh.p.k.) i përshtatshëm për shërbime dhe akomodim të klientëve.

1.5. Akomodimi në Hotel me pension të plotë. Mënyja e ushqimit në 3 racionet me përmbajtje të ushqimit cilësorë e kalorik, ashtu sikurse është saktësuar në Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit.

1.6. Koha e qëndrimit - 5 net e 6 ditë.

1.7. Shërbimet e transportit në pajtim të plotë me kushtet dhe kriteret teknike të specifikuara si në dokumentacionin standard për kuotim, ref. VU644 –26-3898-236

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi menjëherë pas lëshimit të urdhër blerjes.

2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.3 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë sipas specifikimeve teknike në Dosje të Tenderit.

2.4 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në ditë 20.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 4,482.00 (katërmijëekatërqindetëdhjetëdy) Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;**
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;**

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Herolind Retkoceri
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	15.06.2026	Data:	15.06.2026
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

AUTORIZIM

Për: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rekreacion në Prevallë**

Nr. i prokurimit: **644-26-3898-2-3-6**

Unë, i nënshkruari, Herolind Retkoceri, në cilësinë e pronarit Hotel Krojet SH.P.K., me numër biznesi 810135253, në bazë të të drejtave të mia statutore dhe të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës përmes këtij dokumenti të autorizoj dhe përfaqësoj Znj. Marigona Mehmeti, me numër të letërnjoftimit **1242393224**, për të vepruar në emër dhe për llogari të kompanisë Hotel Krojet SH.P.K., duke përfshirë edhe nënshkrimin e kontratës për tenderin e lartcekur

Ky autorizim është i vlefshëm për periudhën e plotë të zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe mbaron me përfundimin e saj ose me kërkesë të veçantë të autorit të këtij autorizimi.

Ky dokument hartohet dhe lëshohet në përputhje me ligjet dhe aktet normative të Republikës së Kosovës dhe është i vlefshëm për të gjitha institucionet dhe autoritetet e përfshira në procesin e prokurimit.

Data: 16.06.2026

Nënshkrimi:

Herolind Retkoceri

Pronar



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT

Për: KOMUNA E VUSHTRRIS

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: HOTEL KROJET SH.P.K. dhe Qazim M. Mustafa B.I.

(në vazhdim "Kontraktori")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Rekreacion në Prevallë

Numri i Prokurimit: 644-26-3898-2-3-6

Garancion me kërkesë të pare

DERISA kontraktori i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE kontraktori obligohet të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar sipas Dosjes së tenderit në rast që Kontraktori dështon të përmbush obligimet sipas marrëveshjes;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim Kontraktorit këtë siguri:

NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, pa asnjë kusht shtesë përveç atyre të cekura me poshtë, deri në një total prej: **448.20€ (katërqindkatërdhjetëetë euro e njëzet cent)**, në emër të kontraktorit në favor të Autoritetit Kontraktues, si siguri që blerësi do përmbush të gjitha obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes, në rast që blerësi dështon të përmbush obligimet e tij.

Ne zotohemi të ju paguajmë, shumën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, deri në maksimumin e limitit të cekur me lartë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën ju deklaroheni:

- që bazuar në gjykimin tuaj, Kontraktori ka dështuar të përmbush obligimet kontraktuale sipas marrëveshjes.
- për shumën që bazuar në gjykimin tuaj Autoriteti Kontraktues kërkon të ekzekutohet nga mos përmbushja e obligimeve kontraktuale

Pagesa në shumën e limituar prej: **448.20** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kërkesa e juaj duhet të shoqërohet me polisen origjinale dhe të dorëzohet në kopje fizike.

Kjo siguri vlen prej 17.06.2026 deri me 10.08.2026

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve



Emri i institucionit financiar

SIGAL Insurance Group

Data: 17.06.2026

Nr.Police: 070020020017917





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 515/26
Dt. 17.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese DKA-së dhe ZPP-së, më dt. **17.06.2026** merë:

V E N D I M

Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Rekreacion në Prevallë, me numër të prokurimit: VU644-3898-236 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-26-026-236**, si vijon :

z.Besim Mehmeti, emërohet menaxher i kontratës.

Znj. Shkëndije Planna Hyseni emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.
- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me

kushtet e Kontratës dhe Porositë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkoj mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpiloi – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm


- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësi dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
 - administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
 - rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.
2. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Operatorit : **Grup i Operatorëve Ekonomik HOTEL KROJET SH.P.K.; Qazim M. Mustafa B.I., Rr. Shqiponjat e Malit, Prevalle, Prizren, të cilët i përfaqëson z. Herolind Retkoceri, në tekstin e mëtejshëm: FURNIZUESI ,**

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtorit të Njesisë Kërkuese

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRIË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 644-26-3898-2-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik HOTEL KROJET SH.P.K.; Qazim M. Mustafa B.I., Rr. Shqiponjat e Malit, 20000, Prevalle, Prizren, Kosovë**

E-mail: **krojetprevalle@gmail.com**

Personi kontaktues: **Herolind Retkoceri**

Telefoni: **045101100**

Faxi: **-**

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **" HOTEL KROJET " SH.P.K.**

Numri fiskal: **810135253**

Vend-Selia: **Rr. Shqiponjat e Malit, 20000, Prevalle, Prizren, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **Qazim M. Mustafa B.I.**

Numri fiskal: **810656738**

Vend-Selia: **Pn Pleshine, 70000, Ferizaj, Kosovë**

e duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së,								
ve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
llë	Persona	18.00	211.02	18.00	249.00	3798.31	683.69	4482.00
TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH						3,798.31	683.69	4,482.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
	Hotel Krojet SH.P.K.
I PËRFAQËSUESIT	Herolind Retkoceri
	02.06.2026



Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1.	-Aktivitete rekreative sociale dhe rehabilituese në Prevallë për klientët rezident në Shtëpinë Komunitetit për Persona me Aftësi të kufizuar mendore e fizike në Vushtri. Qëllimi i aktivitetit është socializimi i klientëve, zhvillimi i autonomisë së individëve dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe atë të komunitetit në përgjithësi përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me shoqërinë, si dhe të kontribuojë në përmirsimin e shëndetit, rritjes së cilësisë së jetës, dhe rehabilitimit fizik. Përshkrimi i projektit dhe kërkesat: 1. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitetë është : 18 persona (12 rezident dhe 6 punëtorë për përkujdesje ndaj klientëve). 2. Vendi i qëndrimit : Hotel në Prevallë-Kosovë, dhe i përshtatshëm për klientë. 3. Koha e qëndrimit – 5 netë e 6 ditë 4. Transporti në relacionin Vushtri – Prevallë dhe anasjelltas. 5. Akomodimi në Hotel me pansion të plotë. 6. Mëny e ushqimit në 3 racionet me përmbajtje të ushqimit cilësorë e kalorik.	Persona	18

Mëngjesi: supë, qaj, qumësht, vezë, salqije, gjalpë të ndryshme ose ekuivalente. Ora 10 Kafe/Qaj/Pije Dreka: Gjella të ndryshme katorike, sallata të ndryshme, ëmbëlsirë, pije të gazuara, lëngje dhe ujë. Mbasdite kafë ose qaj. Ora 16 Kafe/Pije/Qaj Darka: File pule, pleskavicë, peshkë, patate të fërguara, pica, buk misri të pregaditur me qumësht, makarona me sos, qaj ose kafe. 7. Koha e implementimit sipas kërkesës së Shtëpisë së Komunitetit në Vushtrri.		
--	--	--

Aktivitete rekreative sociale dhe rehabilituese për rezidentet e Shtëpisë së Komunitetit për Persona me Afësi të kufizuar mendore dhe fizike në Vushtrri.

Transporti do të kryhet në relacionin Vushtrri-Lum Madh – Prevall dhe anasjelltas.